VENDIM
Nr. 67, datë 22.8.2014

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "GJURR REC" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "MALLA"

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a", 9 dhe 13 pika 1 germa "a", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "a", 5 pika 1 germa "a", 13 dhe 14 pika 1, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Gjurr Rec" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie me fuqi totale 5.455 MW,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë "Gjurr Rec" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Gjurr Rec"sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Malla" me fuqi 5.455 Mw, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti